

Në bazë të nenit 54, paragrafi (1), pika 1), nënpika 1.20 të Ligjit të Energjetikës* ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/25 dhe 135/25), nenit 8 paragrafi (2) të Rregullores së Formimit të Çmimeve më të Larta të Shitjes me Pakicë të Derivateve të Ndryshme të Naftës dhe të Lëndëve Djegëse të Transportit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 108/20, 133/20, 49/22, 54/22, 64/22, 125/22, 218/25, 48/26, 60/26 dhe 87/26) dhe vendimit për përcaktimin e dendësisë së përshkallëzuar ρ_e dhe dendësisë së pashkallëzuar ρ_d të secilit derivat të naftës dhe të lëndës djegëse të transportit, shumës së kompensimit P për premi, shpenzimeve të transportit T deri te depozita e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe shumës së kompensimit D për kompensime për punën përmes depozitës dhe marzhës tregtare me shpenzime të përfshira të transportit nga depozita deri te stacionet e benzinës dhe te konsumatorët e fundëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.109/26) Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 22.06.2026, solli këtë

V E N D I M

për përcaktimin e çmimeve më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit

Neni 1

(1) Çmimet më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit janë:

- Benzinë motori - EUROSUPER BS - 95	-	84,00 (denarë/litër)
- Benzinë motori - EUROSUPER BS – 98	-	86,00 (denarë/litër)
- Naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V)	-	80,50 (denarë/litër)
- Vaj për djegie - EKSTRA I LEHTË 1 (EL-1)	-	79,50 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	42,291 (denarë/kilogram)

(2) Tregtarët me shumicë dhe pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit, mund të formulojnë çmime edhe më të ulëta të derivateve të ndryshme të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit, nga çmimet më të larta të përcaktuara sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të formuara në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, përveç çmimit të Mazutit M-1 SU, vlejné për franko stacion të pompimit, ndërsa çmimi i Mazutit M-1 SU vlen për franko depozitë të tregtarit me shumicë me derivate të naftës dhe lëndë djegëse të transportit në vend.

(4) Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të formuluara sipas këtij neni, përfshihet edhe tatimi i vlerës së shtuar sipas Ligjit të Tatimit të Vlerës së Shtuar.

Neni 2

(1) Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit, të përcaktuara sipas nenit 1 të këtij vendimi, janë përfshirë edhe çmimet më të larta të blerjes, të cilat arrijné vlerën prej:

- Benzinë motori - EUROSUPER BS - 95	-	40,417 (denarë/litër)
- Benzinë motori - EUROSUPER BS – 98	-	42,118 (denarë/litër)
- Naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V)	-	44,514 (denarë/litër)
- Vaj për djegie - EKSTRA I LEHTË 1 (EL-1)	-	43,881 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	31,950 (denarë/kilogram)

Neni 3

Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të përcaktuara në nenin 1 të këtij vendimi, përfshihet edhe kompensimi për shpenzime për punën përmes depozitës dhe marzhës tregtare, e cila për Eurosuperin BS-95 është 6,799 denarë/litër, për Eurosuperin BS-98 është 6,793 denarë/litër, për Eurodizelin BS (D-E V) është 6,876 denarë/litër dhe për Vajin Ekstra të Lehtë 1 (EL-1) është 6,652 denarë/litër, ndërsa për Mazutin M-1 SU kompensimi është 3,00 denarë/kilogram.

Neni 4

Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të përcaktuara në nenin 1 të këtij vendimi, me përjashtim të Mazutit M-1 SU, përfshihet edhe kompensimi për shpenzime të transportit nga depozita deri te stacionet e benzinës në shumë prej 1,00 denarë/litër për të gjitha derivatet e naftës.

Neni 5

Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të përcaktuara sipas nenit 1 të këtij vendimi, është i përfshirë edhe kompensimi për financimin e aktiviteteve nga fusha e mjedisit jetësor, që sipas nenit 184, paragrafi (1), të Ligjit të Mjedisit Jetësor, e paguajnë tatimpaguesit e përcaktuar me këtë ligj:

- Benzinë motori - EUROSUPER BS - 95	-	0,080 (denarë/litër)
- Benzinë motori - EUROSUPER BS – 98	-	0,080 (denarë/litër)
- Naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V)	-	0,030 (denarë/litër)
- Vaj për djegie - EKSTRA I LEHTË 1 (EL-1)	-	0,040 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	0,050 (denarë/kilogram)

Neni 6

Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të përcaktuara sipas nenit 1 të këtij vendimi, është përfshirë edhe kompensimi për rezervat e detyrueshme të naftës dhe të derivateve të naftës, të cilin në pajtueshmëri me nenin 32, paragrafi (1) të Ligjit të Rezervave të Detyrueshme të Naftës e paguajnë prodhuesit e derivateve të naftës dhe importuesit e derivateve të naftës:

- Benzinë motori - EUROSUPER BS - 95	-	0,890 (denarë/litër)
- Benzinë motori - EUROSUPER BS – 98	-	0,890 (denarë/litër)
- Naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V)	-	0,300 (denarë/litër)
- Vaj për djegie - EKSTRA I LEHTË 1 (EL-1)	-	0,300 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	0,740 (denarë/kilogram)

Neni 7

Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë, të përcaktuara sipas nenit 1 të këtij vendimi, akcizat që i paguajnë tatimpaguesit në pajtueshmëri me rregullat e akcizave kanë këto vlera:

- Benzinë motori - EUROSUPER BS - 95	-	22,00 (denarë/litër)
- Benzinë motori - EUROSUPER BS – 98	-	22,00 (denarë/litër)
- Naftë motori - EURODIZEL BS (D-E V)	-	15,50 (denarë/litër)
- Vaj për djegie - EKSTRA I LEHTË 1 (EL-1)	-	15,50 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	0,100 (denarë/kilogram)

Neni 8

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e sjelljes së tij, botohet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe publikohet në faqen e internetit të Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe do të zbatohet nga ora 00:01 datë 23.06.2026.

**Nr. 02-1038/1
22.06.2026**

S h k u p

**Kryetari i Komisionit Rregullator të
Energjetikës, Shërbimeve të Ujit dhe i
Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturinat
Komunale i Republikës së Maqedonisë së
Veriut**

Aco Ristov